



Eco-Higjiena Sh.p.k
Fehmi Agani, Nr.17 60000 Gjilan
NRB: 70856514; NRF: 600816344;
Banka: Raiffeisen Bank: 1507001004573148
Mob: 045-555 242
E-mail: office@ecohigjiena.com : Web: www.ecohigjiena.com

FTESË PËR OFERTË

Datat e publikimit: 26 dhe 27 shtator 2014.

Data e mbylljes: 10 tetor 2014, ora 15:00.

Objekti i kontratës: Auditimi i pasqyrave financiare për periudhën 01.07.2012-31.12.2013, plotësimin e bilancit, rregullsinë e bilancit dhe përputhshmërin me ligjet tatimore të Republikës së Kosovës.

Autoriteti Kontraktues: Ecohigjiena sh.p.k.

Ecohigjiena sh.p.k., me seli në rrugën Fehmi Agani, nr. 17, 60 000 Gjilan, Kosovë, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila është e regjistruar në Agjensionin për Regjistrimin e Bizneseve në Prishtinë me numër 70856514. Aktiviteti kryesor është të ofroj shërbime për grumbullimin, transportimin dhe heqjen e mbeturinave në Regjionin e Gjilanit

Ecohigjiena SH.P.K.Gjilan kërkon kontraktues profesional për të kryer shërbime si më lartë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) dhe në pajtim me Standardet Kosovare të Kontabilitetit - SKK.

Kërkesat për ofertat financiare

- Ofertën tuaj duhet ta dorëzoni tek zyrat e Ecohigjiena SH.P.K., në adresën në rrugën Fehmi Agani , nr.17, 60 000 Gjilan, Kosovë, në pajtim me kërkesat e parashtruara.
- Të gjitha ofertat duhet të dorëzohen në Euro, përfshirë edhe TVSH- në
- Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur.
- Në rast se çmimet dorëzohen pa e specifikuar TVSH-në, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë se çmimet përfshijnë TVSH- në.

Kushtet e përgjithshme:

Ofertat duhet të përmbajnë informatat në vijim:

1. Adresa e plotë dhe detajet kontraktuese të ofertuesit.
2. Detajet e llogarisë bankare të ofertuesit.
3. Numrin e ofertës dhe datën e ofertës.
4. Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë së paku 15 ditë nga dita e dorëzimit.
5. Cdo faqe e ofertës duhet të vuloset dhe nënshkruhet nga personi i autorizuar i Kompanisë.
6. Ofertës duhet t'i bashkangjitet:
 - a. Certifikata e Regjistrimit të Biznesit (kopje);
 - b. Certifikata e TVSH – së (kopje);
 - c. Cerifikata e numrit fiskal (kopje);

Kopja e një dokumenti identifikues të pronarit të ndërmarrjes;

- d. Vërtetimi nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti Ekonomik, se ndaj operatorit ekonomik nuk është filluar ndonjë procedurë gjyqësor (origjinal ose kopje e noterizuar);
 - e. Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatori ekonomik në fjalë, se nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të ofertës (origjinal ose kopje e noterizuar).
7. Auditori i jashtëm duhet të ketë së paku 3 (tre) vjet eksperiencë në fushën e auditimit të pasqyrave financiare.
 8. Ofertës duhet t'i bashkangjitet organogrami organnizativ i ndërmarrjes – luteni që gjithashtu të ofroni një biografi të shkurtër të ekspertëve apo punonjësve të kualifikuar dhe me përvojë në kryerjen e shërbimeve të kërkuara.
 9. Ofertës duhet t'i bashkangjiten tri referenca të lëshuara nga institucionet me reputacion të lartë, që konfirmojnë se ofertuesit kanë ofruar shërbime të ngjashme apo kanë kryer në mënyrë të kënaqshme punë të ngjashme me ato të kërkuara në këtë dokument (jo më të vjetra se tri vjet).
 10. Ofertës duhet t'i bashkangjitet kopja e licencës për të kryer shërbime auditimi në Republikën e Kosovës.
 11. Kushtet dhe rregullat e ofertës:

Dokumentet duhet të vendosen në një zarf të mbyllur dhe të dorëzohen në zyrën e pranimi të Ecohigjiena SH.P.K., në adresën e sipërpërmendur. Kompania do të pranojë vetëm ofertat e juaja të mbyllura në zarf dhe nuk do të konsiderojë asnjë formë tjetër të aplikimit (E-mail, telefon, faks, etj). Kompania nuk pranon përgjegjësi për dëmtimin, humbjen apo mospranimin e zarfave. Numri identifikues duhet të jetë i shkruar në këndin e djathtë të zarfit

- b. Afati për dorëzimin e ofertave është deri ditën e premtën në ora 15.00, datë 10 tetor 2014.
- c. Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën për të ndryshuar specifikat, për të anuluar këtë ofertë, për të ftuar sërish pjesëmarrës të caktuar që ta dorëzojnë prapë ofertën e tyre, si dhe për të diskualifikuar cilindo ofertues pa dhënë njoftime paraprake apo arsye për këtë.
- d. Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën për të mos kontaktuar me ofertuesit gjatë procesit të ofertimit.
- e. Ofertat që nuk u përmbahen kushteve të parashtruara në këtë dokument, diskualifikohen nga procesi i përzgjedhjes.
- f. Përzgjedhja e fituesit bazohet në vlerësimin e Komisionit dhe vendimin e Bordit të Drejtorëve të Kompanisë.
- g. Kjo ofertë do të publikohet në një gazetë ditore të Republikës së Kosovës, si dhe në linkun e Kompanisë : Web : www.ecohigjiena.com

Me respekt

Eco-Higjiena Sh.p.k., Drejtori Ekzekutiv zt. Bajram Isufi